



RRIPI I SIGURISË NË TRAFIK

**Nga data 3 prill 2024 ka hyrë në fuqi
Ligji i ri për Rregullat e Trafikut Rrugor**

Në automjetin për udhëtarë/veturë dhe në mjetin transportues shoferi dhe të gjithë personat të cilët gjenden në mjet duhet t'i përdorin rripat e sigurisë, siç e parasheh prodhuesi i atij automjeti.

Nëse personi i mitur i cili transportohet në mjet nuk e përdor rripin e sigurisë, përgjegjësia bie mbi shoferin e mjetit, ndërsa nëse personi i moshës madhore nuk e përdor rripin e sigurisë, përgjegjësia për këtë e mban vetë personi.



**Mosrespektimi i kësaj rregulle ndëshkohet
me gjobë prej 150 euro.**